



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 410/5 prot.

Tiranë, më 06.05.2026

V E N D I M

Nr. 49, datë 06.05.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET E KRYERA NGA ANA E SUBJEKTEVE TË
NGARKUARA PREJ LIGJIT ME DETYRA SPECIFIKE GJATË REALIZIMIT TË
PROCESIT TË VLERËSIMIT TË REZULTATEVE NË PUNË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për 6-mujorin e dytë të vitit 2025, për nëpunësen Entela Xhakollari,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil janë regjistruar informacionet me shkresat nr. 410 prot., datë 05.03.2026 dhe nr. 410/1 prot., datë 11.03.2026, nëpërmjet të cilave nëpunësja Entela Xhakollari, me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë Ekonomike, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM), ngre pretendime për parregullsi të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë procedurës së ndjekur për vlerësimin e rezultateve në punë, për periudhën 01.07.2025-31.12.2025, për këtë nëpunëse, si dhe paligjshmëri në nxjerrjen e urdhrit të pezullimit të përkohshëm si nëpunëse zbatuese pranë këtij institucioni.

Në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, nëpunësja parashtron se, në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik - Dhjetor 2025, është vlerësuar me nivelin **3** “*Kënaqshëm*”, në kundërshtim me parashikimet e nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”, i ndryshuar.

Gjithashtu, në informacionin e dërguar, nëpunësja sqaron se, në datën 17.02.2026 është njohur me urdhrin nr. 44 (nr. 171/1 prot.), datë 13.02.2026, “*Për pezullimin e përkohshëm të nëpunësit zbatues të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera*”, të titullarit të institucionit, për të cilin pretendon se, është nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi është lëshuar në periudhën kur kjo nëpunëse ka qënë me leje të zakonshme.

Në këto kushte, është kërkuar ndërhyrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të krijuara nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë realizimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë.

Pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga nëpunësja në fjalë, në mbështetje të kompetencave ligjore të sanksionuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Komisioneri vlerësoi se ka dyshime të arsyeshme për parregullsi të lejuara gjatë administrimit të shërbimit civil, e në këto rrethana ka filluar procesin e verifikimit të informacionit. Nëpërmjet shkresës nr. 354/2 prot., datë 25.03.2026, “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të administruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 410/1 prot., datë 11.03.2026, të dërguar nga nëpunësja Entela Xhakollari*”, të Komisionerit, është njoftuar institucioni për fillimin e verifikimit të kësaj procedure vlerësimi, duke i kërkuar dokumentacionin në të cilin është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, institucioni i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, me shkresën nr. 14/8 prot., datë 31.03.2026, me objekt: “*Dërgim dokumentacioni*”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 410/3 prot., datë 01.04.2026, ka dërguar dokumentacionin në të cilin materializohen aktet që pasqyrojnë veprimet administrative që janë kryer gjatë vlerësimit individual të punës për punonjësen në fjalë, për periudhën e 6-mujorit të dytë, viti 2025.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar nga Komisioneri, rezulton se, me aktin nr. 7299 prot., datë 28.12.2021, të Departamentit të Administratës Publike, nëpunësja Entela Xhakollari është emëruar “*nëpunës civil*”, në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë

Ekonomike, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit, pranë institucionit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, kategoria III-a.

Në vijim të marrëdhënies së punësimit në këtë pozicion, nga eprori direkt, i cili mban njëkohësisht rolin e Zyrtarit raportues/kundërfimues/autorizues, është kryer procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën 01.07.2025 – 31.12.2025.

Sa i takon procedurës së ndjekur gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, sqarojmë se, në bazë të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pikës 2, të kreut II, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, që ka dalë në zbatim të kësaj dispozite, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar, është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik dhe duhet të respektohen të gjitha fazat e tij, ashtu si parashikohen në pikën 12, kreu II, i aktit nënligjor në fjalë, e konkretisht:

- Planifikimi, është momenti kur Zyrtari raportues, përcakton objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në fazën e planifikimit përfshihet përgatitja e objektivave dhe e një plani veprimtarish për arritjen e objektivave kryesore. Objektivat kryesorë të punës duhet të jenë të matshëm, kurse veprimet të dukshme. Në këtë fazë Zyrtari raportues dhe nëpunësi që do të vlerësohet diskutojnë së bashku qëllimet e nëpunësit për karriere, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, kjo fazë është realizuar, dhe është dokumentuar me aktin nr. 855/19 prot., datë 19.06.2025, “Objektivat e nëpunësve civilë të Drejtorit të Inspektimit, Drejtorit të Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera, Drejtorit Ekonomik, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit, për vitin 2025 (6 mujori II)”, të titullarit të institucionit, si Zyrtar raportues.

Më tej, me aktin nr. 855/22 prot., datë 20.06.2025, “Fazat e planifikimit, objektivat e nëpunësit civil, për 6 mujorin e II, viti 2025, të sistemit të vlerësimit të rezultateve në punë”, të nënshkruar nga titullari, është caktuar data 01.10.2025, për zhvillimin e takimit të ndërmjetëm midis nëpunëses E. Xhakollari, me detyrë “Drejtor Ekonomik, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit” dhe Zyrtarit raportues.

- Bisedimet e ndërmjetme, zhvillohen në mes të periudhës së vlerësimit, ku Zyrtari raportues takohet me secilin prej nëpunësve që do të vlerësohet për të rishikuar progresin e kryer në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë komente, si dhe për të evidentuar përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.

Rezulton se, me aktin nr. 1382/15 prot., datë 01.10.2025, të Zyrtarit raportues është realizuar takimi për zhvillimin e bisedimeve të ndërmjetme, ku janë sqaruar dhe janë dhënë komentet për të gjitha fazat e vlerësimit, takimi është finalizuar me nënshkrimin e aktit nga ana e të dy pjesëmarrësve në proces.

- Vlerësimi përfundimtar, është një proces që ka të bëjë me vlerësimin e përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesore të punës, duke respektuar afatet e vlerësimit.

Duke marrë në analizë mënyrën se si janë plotësuar ndarjet e formularit, (*ndarjet A, B, C, Ç, D e DH*), nga zyrtarët që ligji i ka ngarkuar me kompetencën e vlerësimit periodik, konstatohet sa më poshtë:

Ndarja A: Të dhënat personale

Në këtë ndarje janë plotësuar të gjitha të dhënat personale të nëpunësit: emri/mbiemri, pozicioni, institucioni, njësia organizative, drejtoria, vendndodhja, data e emërimit në pozicionin aktual, periudha e vlerësimit: 01.07.2025 – 31.12.2025, është përcaktuar Zyrtari raportues, si dhe është shënuar qëllimi i kryerjes së këtij veprimi administrativ, që është vlerësimi 6 mujor i rezultateve në punë.

Ndarja B: Konteksti i punës

Në këtë ndarje janë shënuar objektivat e institucionit dhe objektivat e Programit të Njësive Organizative sipas përcaktimeve në planin e punës së institucionit të miratuar nga titullari, për periudhën 01.07.2025 – 31.12.2025.

Ndarja C: Objektivat dhe matësit e performancës

Rezulton se në këtë ndarje janë shënuar objektivat dhe matësit e performancës për periudhën 01.07.2025-31.12.2025, nga zyrtari i ngarkuar me këtë detyrë.

Kjo ndarje, ka **4** rubrika vlerësimi, në **2** rubrika nëpunësja është vlerësuar nga Zyrtari raportues në nivelin **3** “*Kënaqshëm*”, në **1** rubrikë është vlerësuar me nivelin **2** “*Mirë*” dhe në rubrikën e fundit me nivelin **4**, duke argumentuar në rubrikën komente arsyet e këtij vlerësimi.

Ndarja Ç: Sjellja profesionale

Në këtë ndarje, e cila ka **6** rubrika vlerësimi, në **4** rubrika nëpunësja është vlerësuar nga Zyrtari raportues në nivelin **3** “*Kënaqshëm*”, dhe në **2** rubrika është vlerësuar me nivelin **4**.

Më tej, në cilësinë e organit që ka përcaktuar objektivat e punës, matësit e performancës dhe sjelljen e vlerësueshme profesionale (në faqen 6 të formularit), titullari i institucionit ka nënshkruar formularin.

Në rastin në fjalë, referuar strukturës dhe organikës në fuqi të institucionit, të tre zyrtarët vlerësues: Zyrtari raportues/kundërfirmues dhe autorizues, përfaqësohen nga i njëjti zyrtar, titullari i institucionit, i cili mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative nëpunësen e vlerësuar, në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr.109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Në ndarjen vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë, nëpunësja është vlerësuar në nivelin **3** “Kënaqshëm”.

Ndarja D: Nënshkrimi

Kjo ndarje është plotësuar dhe nënshkruar nga Zyrtari raportues/kundërfirmues dhe autorizues, në datën 05.01.2026.

Sa i takon njoftimit dhe vënies në dispozicion të formularit të vlerësimit për nëpunësen E. Xhakollari, nga dokumentacioni i administruar konstatohet se ky akt i është dorëzuar në datën 25.02.2026, nga zyra e protokollit të institucionit, në tejkalim të afatit të përcaktuar në germën c), pika 12, kreu II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se faza përfundimtare e vlerësimit të rezultateve në punë realizohet në periudhën 1–15 janar.

Më tej, nëpunësja ka nënshkruar formularin në datën 25.02.2026 duke parashtruar se nuk është dakord me vlerësimin dhe ka kërkuar rivlerësim dhe rishqyrtim të procesit të vlerësimit nga ana Zyrtarit Autorizues, fakt që gjen pasqyrim në kërkesën e dërguar me shkresën nr. 14/1 prot., datë 26.02.2026, “Ankim ndaj vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën 1 Korrik 2025 – 31 Dhjetor 2025”, drejtuar titullarit të institucionit, i cili është në cilësinë e Zyrtarit autorizues.

Në vijim, Zyrtari autorizues, bazuar në pikën 2, të kreut V, të aktit nënligjor të sipërcituar, pasi ka shqyrtuar ankimin e nëpunëses, ka kryer të njëjtin vlerësim, me nivelin **3** “Kënaqshëm”, duke e pasqyruar qëndrimin në pikën 1, të ndarjes DH, të formularit të vlerësimit. Për këtë fakt, është njohur edhe nëpunësja me shkresën nr. 14/3 prot., datë 06.03.2026, “Rivlerësim të rezultateve në punë për periudhën e vlerësimit 01.07.2025-31.12.2025”, të titullarit të institucionit.

Pas përfundimit të procesit të ankimit administrativ, Zyrtari raportues ka plotësuar ndarjen E, “Plani i zhvillimit profesional”, të formularit të vlerësimit, materializuar me aktin nr. 14/4 prot., datë 06.03.2026, “Plani i zhvillimit profesional të nëpunësit, për vitin 2026”.

Sa më lart, sa i takon afateve të kryerjes së procesit të vlerësimit për nëpunësen E. Xhakollari, vlerësojmë se, Zyrtari vlerësues i përfshirë në këtë proces, duhet të tregoj kujdes për respektimin e kërkesave të parashikuara në germën c), pika 12, kreu II, i VKM-së nr. 109, datë 26.2.2024, e ndryshuar, ku përcaktohet se: vlerësimi përfundimtar për secilën periudhë vlerësimi realizohet përkatësisht në periudhën 1–15 korrik dhe 1–15 janar. Vonesat në këto afate, sjellin përgjegjësi disiplinore për Zyrtarin vlerësues. Megjithatë, realizimi i këtij procesi jashtë afateve të parashikuara, nuk ndikon në ligjshmërinë e procesit, në ato raste kur, nuk sjell ndonjë pasojë në rezultatin e procesit apo në respektimin e të drejtave të nëpunësit të vlerësuar.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se, procesi i vlerësimit dhe rivlerësimit të nëpunëses Entela Xhakollari, për periudhën 1 Korrik - 31 Dhjetor 2025, është një proces administrativ i rregullt për nga pikëpamja procedurale, pasi janë respektuar rregullat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, për vlerësimin e nëpunësve civilë.

- ✓ Sa i përket pretendimit të ngritur nga nëpunësja E. Xhakollari se urdhri nr. 44 (nr.171/1 prot..) datë 13.02.2026, “*Për pezullimin e përkohshëm të nëpunësit zbatues të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera*”, i titullarit të institucionit, është nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi është lëshuar në periudhën kur kjo nëpunëse ka qënë me leje të zakonshme, sqarojmë se:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, referuar nenit 11, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë. Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, kjo kërkesë e nëpunëses nuk përfshihet në kompetencën e tij lëndore, si rrjedhim, nuk mund të verifikojë ligjshmërinë e aktit.

Në këtë rast, nëpunësja mund të ngrejë pretendimet e saja, nëpërmjet ankimit administrativ pranë organit që ka nxjerrë aktin ose mund të ushtrojë ankim gjyqësor, sipas përcaktimeve të parashikuara në kreun II, “*Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ*”, të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”; si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e

Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacioneve të regjistruara me nr. 410 prot., datë 05.03.2026 dhe nr. 410/1 prot., datë 11.03.2026, të paraqitura nga nëpunësja Entela Xhakollari, pasi nuk u konstatuan shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe procedura e ndjekur nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë realizimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, është kryer në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.
2. Të njoftohet për këtë vendim: Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe nëpunësja Entela Xhakollari.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)